



REPUBLIKA E SHqipëRIE
BASHKIA KORÇË



Nr. _____ Prot

Date 11. 06.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

Date 11.06.2026

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: Bajro Bros shpk, NIPT M113130290, Adresa: Tiranë, Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

Tipi i kontrates: MALLRA

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës REF-86105-05-19-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rafte druri dhe metalike për biblioteken e fëmijëve “Thoma Turtulli” (per nevoja të QAK)”**

Fondi limit: 1,666,040 (një milion e gjshtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyzet) lekë, pa tvsh

Afati: 4 (katër) javë nga data e lidhjes të kontratës

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 20.05.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Datë 25.05.2026, Nr.33

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria Bajro Bros shpk, NIPT M11313029O me vleren:

1.232.100 (një milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

2. Shoqeria BENNETT shpk, NIPT M11707049K me vleren:

1.281.100 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

3. Subjekti Telia Kurti pf, NIPT M12409002V me vleren:

1.350.000 (një milion e treqind e pesëdhjetë mijë) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

4. Shoqeria SHAGA shpk, NIPT J96822229J me vleren:

1.365.000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

5. Subjekti Erblina Beqiri pf, NIPT M22421024U me vleren:

1,389.900 (një milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

6. Shoqeria ALBA STOJKU shpk, NIPT K14229213G me vleren:

1.440.440 (një milion e katërqind e dyzet mijë e katërqind e dyzet) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

7. Shoqëria O&A (O&A) shpk, NIPT M12218017P me vleren:

1.449.900 (një milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

8. Subjekti Eduart Xhixha pf, NIPT L54424205B me vleren:

1,508.200 (një milion e pesëqind e tetë mijë e dyqind) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Subjekti Telia Kurti pf me arsyen:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për përmbushjen e kriterit 2.2.1 “Përvoja e ngjashme”, konstatoi se operatori ekonomik ka paraqitur faturën tatimore nr. 30/2022, datë 26.07.2022, me objekt “Materiale zyre për inaugurim aktiviteti”, si dokument provues të furnizimeve të mëparshme të ngjashme. Referuar kërkesës së përcaktuar në Dokumentet e Tenderit, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë realizimin e furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Fatura e paraqitur nga operatori ekonomik mban datën 26.07.2022 dhe, për rrjedhojë, i përket një periudhe jashtë afatit 3-vjeçar të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, duke mos u konsideruar e vlefshme për provimin e përvojës së ngjashme. Në këto kushte, operatori ekonomik nuk ka arritur të provojë përmbushjen e kriterit 2.2.1 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional, sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bazuar në nenin 92, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, si dhe në nenin 82, pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, vendos skualifikimin e operatorit ekonomik, pasi oferta e tij nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

2. Shoqëria Shaga shpk me arsyen:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, konstatoi se ky i fundit nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit lidhur me paraqitjen e ofertës ekonomike. Konkretisht, në Dokumentet e Tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë “Përshkrimin e Ofertës”, sipas Shtojcës 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike” dhe Shtojcës 3 “Lista e Çmimeve të Artikujve”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur Shtojcën 1, por nuk ka paraqitur Shtojcën 3 “Lista e Çmimeve të Artikujve” sipas zërave dhe specifikimeve të preventivit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit. Mungesa e këtij dokumenti nuk i mundëson Autoritetit Kontraktor verifikimin e plotë të

ofertës ekonomike, të çmimeve për secilin artikull dhe të përputhshmërisë së ofertës me kërkesat e procedurës së prokurimit. Për rrjedhojë, oferta nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe nuk mund të konsiderohet e pranueshme. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bazuar në nenin 92, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 82, pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, vendos skualifikimin e operatorit ekonomik, pasi oferta e paraqitur nuk është në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

3. Subjekti Eduart Xhixha pf me arsyen:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, konstatoi se nuk është përmbushur kriteri 2.2.4 i Dokumenteve të Tenderit, sipas të cilit operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e mallrave që kërkohen të prokurohen, nëpërmjet së cilës të marrë përsipër garantimin e riparimit, mirëmbajtjes dhe shërbimit pa pagesë për defektet që rrjedhin nga prodhimi dhe montimi, për një periudhë jo më të vogël se 1 (një) vit nga data e marrjes në dorëzim të artikujve nga Autoriteti Kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën e kërkuar për garancinë e mallrave, duke mos provuar marrjen përsipër të detyrimeve të mësipërme për periudhën minimale të garancisë së përcaktuar në Dokumentet e Tenderit. Mungesa e këtij dokumenti përbën mosplotësim të një kërkesë të veçantë të kapacitetit teknik dhe profesional të vendosur nga Autoriteti Kontraktor. Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.2.4 të Dokumenteve të Tenderit. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bazuar në nenin 92, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, si dhe në nenin 82, pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, vendos skualifikimin e operatorit ekonomik, pasi nuk ka përmbushur kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ofertuesin “Bajro Bros” Shpk, NIPT M113130290, Adresa: Tiranë, Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1.232.100 (një milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e njeqind) leke pa tvsh., është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI KLETJON KITA